

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
 MINISTRIA E EKONOMISE
 MINISTARSTVO EKONOMIJE
 MINISTRY OF ECONOMY

Njësia Org. 01/3
 Org. Jedin.
 Org. Unit
 Nr. i fletëve
 Broj strana
 No pages

Nr. Prot. 2136
 Br. Prof.
 Prof. No.
 Data: 13.05.25
 Datum:
 Date:

PRISHTINE/A



KRU Hidroregjioni Jugor sh.a. Prizren

Adresa: Westly Clark p.n., 20000 Prizren
 email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

KOMANDA RAJONALE E UJESJELLËS
 REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOPOSREDEVANJE
 »HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.

Nr. 1749
 Dt. 12.05 2025
 PRIZREN

Bordi i Drejtorëve në K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A me seli në Prizren, në përputhje me nenin 31 (31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligjit Nr.04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 12.05.2025, mori këtë:

VENDIM

RAPORTI VJETOR - 2024

Bordi i Drejtorëve miratoi Raportin Vjetor për vitin 2024 në mbledhjen e 2 (dytë) të mbajtur me datë 12.05.2025.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	UD. Kryeshf Ekzekutiv Fadil Berisha	Kryesuesi i BD Ylber Elshani
Nënshkrimi		
Data	12.05.2025	12.05.2025



KRU Hidroregjioni Jugor sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njesia Org. Org. Jedin Org. Unit Nr. i faqesve Broj stranica No. pages	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. Dhita Datum Date
01/3	2136
1	130525
PRISHTINE/A	NO.1

KOMPANIA RAJONALE E UJESJELJEZIT REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE »HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.	
Nr.	1749
Dt.	12.05 2025
PRIZREN	

RAPORT VJETOR 2024

KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A. – PRIZREN

PËRMBAJTJA

I.	QËLLIMI	4
II.	METODOLOGJIA	4
III.	RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	5
IV.	AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	11
V.	DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES	13
5.1	PRODHIMI m3.....	13
	PRODHIMI- REALIZIMI I CAQEVE- 2024	14
5.2	SITUATA E FURNIZIMIT.....	14
5.3	AKTIVITETET KRYESORE.....	15
5.3.1	AKTIVITETET PËR ZVOGLIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE	16
5.3.2	MIRËMBAJTA - SANIMI I DEFЕКТЕVE	17
5.3.3	SERVISIMI I UJËMATËSAVE DHE DETEKTIMI	17
5.3.4	CILËSIA E UJIT	18
VI.	DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....	19
6.1	PERFORMANCAT - 2024	19
6.1.1	NUMRI I KONSUMATORËVE.....	19
6.1.2	FATURIMI – m3.....	21
6.1.3	FATURIMI – €	23
6.1.4	ARKËTIMI – €	25
6.2	KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....	27
6.2.1	AKTIVITETET KRYESORE.....	27
6.2.3	INSPEKTIMI DHE SHKYÇJA	28
VII	DEPARTAMENTI I FINANCAVE.....	29
7.1	KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI I FINANCAVE	29
7.1.1	AKTIVITETET KRYESORE.....	29
7.1.2	ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE	30
VIII	PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE.....	34
8.1	PERFORMANCAT 2023-2024	34

1.2	DRAFT PASQYRAT FINANCIARE – 2023-2024	35
IX	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	38
9.1	KOMENTET KRYESORE.....	38
9.2	ZYRA LIGJORE	40
X	DEPARTAMENTI I UN -ITUN	42
10.1	KOMENTET KRYESORE.....	42
10.1.1	FUSHËVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TË -ITUN	42
XI	RAPORT NGA ZYRA E PROKURIMIT	48
XII	SFIDAT - 2024	56
XIII	MASAT E PROPOZUARA - 2025	57
XIV	ORGANOGRAMI	58

SHKURTESAT

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BD	Bordi i Drejtorëve
KA	Komisioni i Auditimit
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
KNMU	Këshillit Ndërmintor për Ujëra
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
NJPMNP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
UPF	Uji i pa-faturuar
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
SHUKOS	Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimit të Kosovës
NJOU	Njësia Operative e Ujësjellësit
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujit të Ndotur.
NP	Ndërmarrjet Publike
DP	Departamenti i ujit
DK	Departamenti Komercial
KfW	Banka gjermane për zhvillim
TM	Tre mujori

I. QËLLIMI

Me anë të Raportit vjetor (gjithëpërfshirës) për vitin 2024, Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti dhe të punësuarit e tjerë në Kompaninë Rajonale të Ujit "Hidroregjioni Jugor" sh.a. paraqesin të gjitha faktet reale, sukseset, dështimet, vështirësitë, sfidat etj., që e kanë shoqëruar punën e ndërmarrjes prej datës 01.01.2024 deri më 31.12.2024.

Ky raport shërben për të vënë në dijeni me të gjitha aktivitetet që janë ndërmarrë nga të gjitha palët e interesit, në rend të parë Ministrinë e Ekonomisë në cilësinë e pronarit të aksioneve, Bordit të Drejtorëve, Autoritetet tjera të pavarura, të punësuarit në ndërmarrje, konsumatorët, bankat, donatorët si dhe të gjithë të interesuarit e tjerë.

Gjithashtu, përmes këtij Raporti, menaxhmenti synon të ofrojë transparencën maksimale, duke publikuar të gjitha aktivitetet që e kanë përcjellë punën e ndërmarrjes gjatë vitit 2023. Parimi themelor që mendohet të arrihet me këtë Raport është edhe llogaridhënia përpara të gjithëve, veçanërisht palëve të interesit të implikuar në këtë proces.

II. METODOLOGJIA

Raporti është përpiluar duke marrë për bazë, Ligjin Për Ndërmarrjet Publike (NP), Kodin e Etikës dhe Qeverisjës Korporative për Ndërmarrjet Publike, Udhëzuesin e Auditimit të Brendshëm për Ndërmarrjet Publike në Kosovë, si dhe udhëzues të raportimeve nga ARRU (Autoriteti Rregullativ i Ujërave)

Po ashtu është marrë për bazë edhe përvorjet pozitive të Raportëve vjetorë

paraprake, njohurive empirike si dhe formave dhe formateve të shumta të raportimeve brendshme për menaxhmentin dhe raportimeve të jashtme për palët e interesit etj.

Me qëllim që Raporti të jetë i qartë dhe më i kuptueshëm për të gjithë është ndërtuar në bazë të:

Pjesës tekstuale (përshkruese- narrative),

Pjesës së tabelave- shifrave (numrave) dhe

Pjesës së grafikeve

Në Raport, janë bërë krahasimet me vitin paraprak (2024) dhe me Planin e biznesit për vitin 2024, si dhe me caqet e miratuara nga ARRU, bazuar në aplikimin tarifor për KRU-të

Raporti merr në konsideratë dhe është përmbledhje përkatësisht sintetizim i raporteve analitike të Departamenteve dhe Autoriteteve të tjera brenda KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a. (Raportëve mujore dhe tre mujore të të gjitha shërbimeve)

III. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Emrat e drejtorëve të bordit të drejtorëve

KRU Hidroregjioni Jugor SH.A Prizren është udhëhequr nga Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim Nr. 04/92 të datës 10.08.2022.

Bordi i Drejtorëve fillimisht ka qenë i përbërë nga 6 drejtor në përbërje:

Feim Fetoshi- Kryesues,

Hysni Çanta- anëtar,

Mirlinda Morina - anëtare, (KA)

Naim Kukaj- anëtar,

Biljal Karadolami – anëtar dhe

Arben Hajrizi- anëtar (ka dhënë dorëheqje 11.11.2023)

Bordi i Drejtorëve i K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, me seli në Prizren është shkarkuar nga detyra nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 13/191, datë 05.03.2024.

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, me seli në Prizren, është emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 13/191, datë 05.03.2024, në përbërje të :

Ismet Vrapcani – Kryesues,

Dhurata Gutaj – anëtare,

Taulant Tanushaj – anëtar, (KA) dhe

Sibel Halko Shatri – anëtare.

Me datë 05.09.2024, Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve në K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, me seli në Prizren i ka përfunduar mandati.

Numri i takimeve të Bordit të Drejtoreve gjatë vitit 2024

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

(të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 04/92 të datës 10.08.2022)

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	31.01.2024	Prizren	BD.i rregullt
2	29.02.2024	Prizren	BD. I rregullt
MBLEDHJET E BORDIT TË PÛRKOHSHËM TË DREJTORËVE K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN (të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 13/191 të datës 05.03.2024)			
3	05.04.2024	Prizren	BD. I përkohshëm
4	16.05.2024	Prizren	MVA
5	29.05.2024	Prizren	BD. I përkohshëm
6	02.08.2024	Prizren	BD. I përkohshëm
7	05.09.2024	Prizren	BD. I përkohshëm

MBLEDHJET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT

K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

(të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.1908 të datës 15.08.2022)

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	24.01.2024	Prizren	KA nga BD i rregullt
MBLEDHJET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT			

K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN (të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.2749 të datës 18.03.2024)			
2	22.03.2024	Prizren	KA nga BD i përkohshëm
3	26.04.2024	Prizren	KA nga BD i përkohshëm
4	22.07.2024	Prizren	KA nga BD i përkohshëm

Aktivitetet tjera të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2024

Raporti vjetor i Bordit të Drejtorëve në KRU”Hidroregjioni Jugor”SHA në Prizren, në formë përmbledhëse përfshinë aktivitetet kryesore të Bordit të Drejtorëve dhe Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të realizuara gjatë muajve Janar - Shtator 2024.

Bordi i Drejtorëve, respektivisht Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve gjatë muajve Janar – Shtator 2024 ka mbajtur shtatë (7) takime të rregullta mujore.

Sipas procesverbaleve takimet e Bordit janë mbajtur me këto data: 31.01.2024, 29.02.2024, 05.04.2024, 16.05.2024, 29.05.2024, 02.08.2024 dhe 05.09.2024 (formë elektronike).

KRU Hidroregjioni Jugor SH.A Prizren është udhëhequr nga Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim Nr. 04/92 të datës 10.08.2022.

Bordi i Drejtorëve fillimisht ka qenë i përbërë nga 6 drejtor në përbërje: Feim Fetoshi- Kryesues, Hysni Çanta- anëtar, Mirlinda Morina - anëtare, Naim Kukaj- anëtar, Arben Hajrizi- anëtar (ka dhënë dorëheqje 11.11.2023) dhe Biljal Karadolami – anëtar. Kurse tani përbëhet nga 5 drejtorë. Bordi i Drejtorëve i K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, me seli në Prizren është shkarkuar nga detyra nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 13/191, datë 05.03.2024.

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, me seli në Prizren, është emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 13/191, datë 05.03.2024, në përbërje të : Ismet Vrapcani – Kryesues, Dhurata Gutaj – anëtare, Taulant Tanushaj – anëtar dhe Sibel Halko Shatri – anëtare. Me datë 05.09.2024, Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve në K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, me seli në Prizren i ka përfunduar mandati.

Në këto takime Bordi i Drejtorëve përveç diskutimeve të frytshme poashtu ka marrë veprimet si vijon:

Aktivitetet e Bordit të Drejtorëve – Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve gjatë vitit 2024

- Bordi i Drejtorëve vendosi për shpalljen e konkursit publik për Kryeshef Ekzekutiv.
- Miratoi kërkesën për plotësim – ndryshimin e rregullores Nr.Pr. 735 e datës 20.03.2023.
- Miratoi raportin e TM4 – 2023.
- Miratoi raportin vjetor 2023.
- Miratoi raportin e kënaqshmërisë së konsumatorëve 2023.
- Miratoi raportin e auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare të audituara për vitin 2023.
- Aprovoi planin e menaxhimit të asetëve
- Miratoi raportin TM1 – 2024.
- Në emër të ruajtjes së parasë publike dhe shpenzimeve të panevojshme ndërpreu të gjitha marrëveshjet komerciale me objekt provizioni si dhe të gjitha marrëveshjet për shpenzime të reklamimit dhe njoftimeve.
- Ndërpreu pagesat për programin – platformën EDAMS, pasi që i njëjti nuk përdoret dhe është i panevojshëm për kompaninë.
- Aprovoi ndryshimet e statutit të KRU HRJ.
- Aprovoi draft – rregulloren e brendshme për konkurset publike.
- Miratoi raportin TM2 – 2024.

Raport vjetor i punës së Komisionit të Auditimit për vitin 2024.

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit të KRU "Hidroregjioni Jugor" SHA në Prizren, në formë përmbledhëse përfshin aktivitetet kryesore të Komisionit të Auditimit të realizuara gjatë vitit 2024.

Bazuar në procesverbalet zyrtare të mbajtura, gjatë këtij viti, janë mbajtur katër (4) takime të Komisionit të Auditimit. Poashtu, shumë çështje janë shqyrtuar drejtpërdrejtë në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve.

Takimi i Komisionit të Auditimit është mbajtur me datë 24.01.2024, me përbërje të 2 anëtarëve, Mirlinda Morina - Kryesuese e Komisionit të Auditimit, Naim Kukaj - anëtarë i K.A.

Në këtë takim, janë diskutuar dhe shqyrtuar disa tema të paraqitura si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Propozimi dhe aprovimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i raportit të performancës për muajin Dhjetor 2023;
4. Shqyrtimi i raportit TM4 / 2023;
5. Të ndryshme;

Në këtë takim Komisioni i Auditimit kërkoi:

- KA kërkoi nga UD. Kryeshefi Ekzekutiv që të raportoj – bëjë një përmbledhje për aktivitetet dhe performancën e kompanisë gjatë muajit dhjetor 2023.
- KA, shqyrtoi raportin TM4 / 2023.

MBLEDHJET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT

K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

***(të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.2749 të datës
18.03.2024)***

Takimi i parë i Komisionit të Auditimit është mbajtur me datë 22.03.2024, me përbërje të plotë të 3 anëtarëve: Taulant Tanushaj – Kryesues, Dhurata Gutaj – anëtare dhe Sibel Halko Shatri – anëtare.

Në këtë takim, janë diskutuar dhe shqyrtuar disa tema të paraqitura si në vijim:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i draft – raportit vjetor të vitit 2023
3. Shqyrtimi i progresit të projektit KFW – në
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2024
5. Raporti i ZAB për periudhën Janar – Mars 2024
6. Të ndryshme

Në këtë takim Komisioni i Auditimit kërkoi / vendosi:

- KA, kërkoi që draft – raporti vjetor për vitin 2023 në përmbajtjen e tij ka disa detaje dhe informata të parëndësishme të cilat nuk flasin për performancën e kompanisë, duhet të rishqyrtohen dhe ndryshohen. Raporti duhet të jetë më i qartë dhe përmbledhës, të jenë të evidentuara çështjet kryesore dhe të arriturat të cilat kanë ndikuar në performancën e ndërmarrjes.
- KA, kërkoi nga ZKF që raportet financiare gjithmonë të ju dorëzohen për shqyrtim përpara mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të KA, si dhe raportet për muajin e kaluar të përfundohen me datë 15 të muajit vijues.
- KA, rekomandoi që në mbledhjen e Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të shqyrtohet konkursi për Kryeshef Ekzekutiv në KRU HRJ.

Takimi i dytë i Komisionit të Auditimit është mbajtur me datë 26.04.2024, me përbërje të plotë të 3 anëtarëve.

Në këtë takim janë diskutuar dhe shqyrtuar disa tema të paraqitura si në vijim:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i draft – procesverbalit të takimit paraprak
3. Raporti i ZKF për performancën financiare
4. Raporti i ZAB për aktivitetet e zyrës së auditimit të brendshëm
5. Të ndryshme

Në këtë takim Komisioni i Auditimit kërkoi / vendosi:

- KA, nga ZKF kërkoi sqarime të detajuara rreth shpenzimeve financiare të kompanisë
- KA, kërkuan që zyra e auditimit të brendshëm me qenë shumë aktive
- KA, diskutoi edhe për plotësimin e pozitave të lira të punës në kompani
- Ka, kërkoi që në mbledhjen e Bordit të diskutohet skema organizative, avancimet në pozitat e punës dhe sistematizimi i vendeve të punës si dhe çështja e nivelizimit të pagave.

IV. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Aktivitetet kryesore

- Formimi i task forces për zvoglimin e humbjeve të ujit
- Menagjimi i situatave emergjente si pasoje e defekteve të paparashikuara në rrjetin kryesor të furnizimit, nga operatore ekonomik (investime nga Donatorët (KfW), Ministria e Infrastruktura dhe Kuvendi Komunal
- Nenshkrimi i Marreveshjeve të bashkepunimit në mes të KRU „Hidroregjioni Jugor“, Ministrisë së Ekonomisë, ARRU, Kuvendeve Komunale, Universitetit dhe Postës së Kosovës
- Takime të rregullta të menaxhmentit,
- Takime të rregullta me SHUKOS, ARRU dhe Donatorë,
- Takime me Kryetarët e Komunave, Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash, me Kryetar të fshatrave dhe lagjeve, Donatorë, KfW, Konsulencën dhe përfaqësues të KK- Prizren
- Aplikimi në Projektin e Ballkanit Perëndimor - Kompanitë Rajonale të së Ardhmes, një iniciativë transformuese e mbështetur nga Banka Botërore dhe Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), i cili synon mbështetjen e shërbimeve të ujit dhe sanitetit në Ballkanin Perëndimor."
- Aktivitete në kuader të Dites Botërore të Ujit.
- Takim pune në mes të Komisioni parlamentar të Kosovës dhe përfaqësuesve të institucioneve tjera të sektorit të ujit – Sfidat e sektorit të ujit.
- Zgjidhja e problemit të Lokalitetit Arkeologjik në Sheshin Adem Jashari
- Nenshkrimi i Kantratës për Ofrimin e Shërbimeve të Sigurimit Shëndetësorë të stafit të KRU „Hidroregjioni Jugor" Sh.A - Prizren.
- Përmirësimi i kushteve të punës, sigurimi i makinerisë së nevojshme; kamioneta, deblllokues dhe vetura. (Për nevoja të operativës dhe shërbimit të kanalizimit)
- Pergaditja e zbatimit të kërkesës së agjencisë për informim dhe privatësisë- Ndërprerja e dorëzimit të faturave para banesave apo shtëpive.
- Takim me përfaqësues të KfW- ITUN.
- Përfundimi i të gjitha procedurave dhe sigurimi i gjeneratorëve tek burimet kryesore
- Pergaditja e memorandumit për dislokimin e rezervuarit të kalasë – rishikimi i paramasave.
- Zgjidhja e problemit të dislokimit të rrjetit të ujësjellësit në Rr. Tirana.
- Zgjidhja e problemit të dëmtimit të kaptazhes në burimet në SOZI-Nashec.
- Menagjim i situatës së furnizimit, si pasoje e këtyre dëmtimeve nga palët e treta.
- Përgatitja dhe dorëzimi i aplikimit tarifor – 2025

- Përmirësimi i shërbimeve me konsumatorë- Qendra e thirrjeve, publikimi me kohe i te gjitha informatave. (Instalimi i numrit pa pagese për konsumatorë).
- Prononcime me media- organizime te konferencës per shtyp, emisione te drejtpërdrejtë si dhe intervista te tjera.
- Përgatitja e Plan Bisnesit 2025-2027
- Përgatitja e projektit: "Dislokimi i Rez. Kalaja" tek ministria e Kulturës, rinisë dhe sporteve.
- Vizita në teren në kuadër të mbikëqyrjeve të projekteve.
- Koordinim i përbashkët me te gjitha KRU dhe ME- mbështetja me autobote per KEK, KRU „Prishtina” dhe KRU „Mitrovica”
- Inicimi i procedurave për përgatitjen e projekt propozimit për shtimin e kapaciteteve të ujit të pijes në Prizren.
- Zgjidhja e problemit te energjisë elektrike- St. i pompave ne Vermicë.
- Pjesëmarrja në Konferencën e ujërave.
- Përgatitja e planit për instalimin dhe ndërrimin e ujëmatësve.
- Identifikimi dhe inventarizimi i rrjetit te ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Identifikimi i sakte i konsumatorëve pa ujëmatës, konsumatorëve me ujëmatës jo funksional.
- Rritja e efikasitetit te punës, llogaridhënies. Marrja e masave disiplinore.


V. DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES

5.1 PRODHIMI m3

Tabela nr. 1 – Prodhimi – 2023-2024 dhe Caqet 2024

JANAR-DHJETOR - 2024				
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN				
PRODHIMI - m3				
NJËSIA PUNUESE	2023		2024	
	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	736.3	23,219,584	740.6	23,354,070
SUHAREKË	144.0	4,542,743	141.8	4,473,192
MALISHEVË	82.9	2,615,488	77.4	2,441,429
DRAGASH	30.4	957,996	29.1	917,439
TOTAL	993.7	31,335,811	988.9	31,186,130
NDRYSHIMI l/sec				(149,681)
NDRYSHIMI %				-0.48%

Diagrami nr. 1 – Prodhimi – 2023-2024 dhe Caqet 2024




PRODHIMI- REALIZIMI I CAQEVE- 2024

Tabela nr. 2 – Prodhimi - Caqet 2024

JANAR-DHJETOR - 2024				
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN				
P R O D H I M I - m ³				
NJËSIA PUNUESE	2024		2024 (PB)	
	l/sec	m ³	l/sec	m ³
PRIZREN	740.6	23,354,070	688.6	21,716,181
SUHAREKË	141.8	4,473,192	143.4	4,520,969
MALISHEVË	77.4	2,441,429	87.5	2,758,537
DRAGASH	29.1	917,439	31.5	994,653
TOTAL	988.9	31,186,130	951.0	29,990,340
NDRYSHIMI l/sec			37.92	1,195,790
NDRYSHIMI %				3.99%

Diagrami nr. 2 – Prodhimi - Caqet 2024



5.2 SITUATA E FURNIZIMIT

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes, në TM e parë të vitit jemi ballafaquar me reduktime të pjesshme të furnizimit. Në TM2 deri me datën 14 Korrik 2024, falë edhe aktiviteteve të shumta, kemi arritur të sigurojmë furnizim të rregullt pa asnjë reduktim në të gjithë zonën e furnizimit.

Nga data 14 Korrik, për shkak të rënies së nivelit të ujit në burimet kryesore, infrastrukturës së pavoritshme ekzistuese të rrjetit shpërndarës, tej konsumit sezonal-keqpërdorimeve dhe shfrytëzimit joracional, gjithashtu mungesa e energjisë ekektrike (prishjet në rrjetin distributiv – KEDS) dhe mungesa të pjesshme të furnizimit në disa lokalitete nga prishjet teknike në

rrjetë, infrastrukturës elektropomuese dhe faktorëve tjerë eventual, duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, furnizimi ka qenë kryesisht i rregullt por parciaisht i shoqëruar me ulje presioni në disa zona më të larta dhe vazhdimin e pjesshëm të reduktimeve të furnizimit në Prizren, në disa rrugë kryesore dhe lagje, si “Jeta e Re”, lagja “Arbana”, lagja “Ortakolli” (pjesërisht) lagja “Bazhdarhane”, lagja “Terhimahalla”, Ne Suharekë: fshatrat Samadraxhë dhe Deberdelan

Në Malishevë, Pjesërisht fshati Drenoc, Banjë disa lagje, në Malishevë pikat e larta.

Furnizimi jo-stabil dhe jo i kënaqshëm rezultohet nga shumë faktor por esencialisht nga niveli i prurjeve të burimeve ujore të ndikuara nga mbizotërimi i kushteve klimatike, gjendjes së gjithmbarshme teknike të infrastrukturës hidro-elektro-makinerike, shërbimeve operuese e mirëmbajtëse dhe investimeve kapitale për përmirësimin e rrjetit sipas proritizimit në të gjitha zonat furnizuese brenda mbulueshmërisë së Kompanisë.

5.3 AKTIVITETET KRYESORE

Angazhimi i përditshëm për funksionimin optimal të Departamentit të Ujit të Pijes dhe Kompanisë.

- Takime të rregullta ditore, javore dhe mujore me menaxhmentin, njësitë punuese dhe palët e interesuara.
- Koordinimi për zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe përmirësimin e shërbimeve.
- Takime me komunat dhe institucionet qeveritare për çështje të furnizimit me ujë.
- Diskutime me donatorë dhe operatorë ekonomikë për investime dhe projekte të përbashkëta.
- Takime specifike për adresimin e problemeve emergjente, si rrjedhjet e ujit dhe ndërprerjet e furnizimit.
- Monitorimi dhe menaxhimi i sistemeve elektropompuese dhe furnizimeve për mirëmbajtje.
- Intervenime për sanimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit, përfshirë devijimin e gypave kryesorë.
- Rritja e masave të sigurisë për burimet ujore përmes vizitave të shpeshta dhe monitorimit të gjendjes së tyre.
- Instalimi i tre gjeneratorëve në stacionet kryesore të pompimit (40-Burimet, ZOSI), me qëllim të përmirësimin të furnizimit me ujë.
- Përgatitja e projekteve kapitale për Aplikimin Tarifor 2025 dhe Plan-Biznesin 2025.
- Rikonstruksioni i burimit “SOZI” në Nashec dhe aftësimi i tij për furnizim të qëndrueshëm.

- Hartimi i projektit për investime kapitale në fshatin “Gërçar”, projekt i mbështetur nga Ministria e Ekonomisë (ME).

Hartimi i projektit për investime kapitale “Rehabilitimin e rrjetit në fshatin Lutogllavë”, projekt i cili do të mbështetet nga KK-Prizrenit.

Hartimi i projektit për investime kapitale, dislokimi i rezervuarit “Kalaja” në Prizren, projekt i cili do të mbështetet nga MKRS.

- Studim dhe projektim për shfrytëzimin e burimit “Vermicë” për shtimin e kapaciteteve të ujit.

- Njoftim i menaxhmentit për rënien e nivelit të ujit në burimet kryesore.

Fillimi i aplikimit të reduktimeve (Gusht-2024) për lagje të ndryshme të qytetit.

- Takime me banorët e lagjeve (Bajram Curr, Hoqamalla, Arbana, etj) për ndryshimin e orarit të reduktimeve.

- Takim me Kryetarin e Komunës së Malishevës për çështjen e ndërprerjeve të rrymës me orare të gjata dhe ndikimin në furnizimin me ujë.

- Diskutime me përfaqësues të KK-Prizren për trajtimin e rrjedhjeve të ujit në Lokalitetin Arkeologjik, objek i cili ndodhet brenda zonës historike të Prizrenit.

- Takim informues me KFOR-in Anglez për situatën e furnizimit me ujë.

- Takim me ARRU për zgjidhje të problemeve të ujit për komunën e Mamushës.

- Raportime dhe koordinim me DSHP-KK Prizren për mbështetje në projekte të rehabilitimit të rrjeteve të amortizuara të ujësjellësit.

- Kompletimi dhe regjistrimi si asete të projekteve të përfunduara sipas Plan-Biznesit 2024.

5.3.1 AKTIVITETET PËR ZVOGLIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE

- Përpilimi i planeve operative ditore dhe periodike me të gjitha shërbimet përkatëse dhe intervenimet në sanimin e prishjeve në rrjetë, rrjedhjeve të pakontrolluara, shkyçjen e lidhjeve ilegale, etj.
- Mbështjettja për konsolidim të divizionit për UPF.
- Monitorimi dhe mirëmbajtja e ujëmatësve të prodhimit në të gjitha pikat furnizuese në nivel të kompanisë.
- Detektimi i rrjetit të ujësjellësit, ndërrimi i ujëmatësve dhe ndarja e zonave për detektim për zvogëlimin dhe eliminimin optimal të humbjeve teknike.
- Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit dhe segmenteve tjera në zonën e mbulueshmërisë me prishje të shpeshta dhe jofunksionalitet të duhur sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemet monitoruese aplikative, shërbimit operativ dhe

matjeve në teren përmes investimeve të vazhdueshme vetanake dhe bashkëinvestimeve me komunat, qeverinë dhe institucionet tjera financiare.

- Investimi i vazhdueshëm në infrastrukturën fizike dhe humane me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore në tërë fushëveprimtarinë e Kompanisë.

5.3.2 MIRËMBAJTA - SANIMI I DEFЕКТЕVE

Tabela nr. 3 – Sanimi i defekteve- 2024

Njësia Operative	Ujësjetllësi - uji i pijes
Prizren	2,706
Suharekë	441
Dragash	54
Malishevë	388
Total	3,589

Koment: Numri i intervenimeve, sanimi i defekteve, ne krahasim me vitin 2023 është rritur ne 28.7 % (+801)

5.3.3 SERVISIMI I UJËMATËSAVE DHE DETEKTIMI

Tabela nr. 4 – Servisimi i ujëmatësave- 2024

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti i Ujit të Pijes (DUP)		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajve Janar-Dhjetor, 2024	
Kalibrim i ujëmatësve	558	riparime të ujëmatësve
Ndërrimi i ujëmatësve (D-M)	2,314	vizita të konsumatorët
	1,365	ndërrime të ujëmatësve
	378	riparim të defekteve gjatë ndërrimit
Detektimit të rrjetit	661	detekttime
	415	defekte të gjetura
	17,150	rrjet i detektuar (m)

5.3.4 CILËSIA E UJIT

Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në qytet dhe në fshatra.
Kontrolli permanent i kualitetit të ujit në burime dhe në puseve të cilat shfrytëzohen për momentin.
Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorinimit për punën e procesit të klorinimit dhe paisjeve.
Furnizim i stacioneve të klorinimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.
Marrja e mostrave sipas Planit për monitorim të cilësisë së ujit.
Riparim i sistemit të klorinimit të "Galeria I" dhe në Novakë.
Nënshkrimi i marrvëshjes së mirkuptimit me ISHP-Prizren për kryejën e analizave dhe analizat C të cilat laboratorit i ynë nuk ka mundësi të bëjë, ato bëhen në Prishtinë përmes ISHP-së Prizren.

Tabela nr. 5 – Analizat e ujit - 2024

NJËSIA	Lloji i ujit	Numri i mostrave	Numri i mostrave të dështuara
PRIZREN	Ujësjiellës	1,782	1
DRAGASH	Ujësjiellës	110	3
SUHAREKË	Ujësjiellës	254	1
MALISHEVË	Ujësjiellës	234	4
TOTAL		2,380	9

Vërejtje: Nga tabela nga ISHP janë marrun 2380 mostra dhe 9 nuk i përgjigjen standardit për ujin e pijes 0.37%.

Ose 99.63% e mostrave të marra për analizë janë në suaza të standardeve për ujin e pijes.

VI. DEPARTAMENTI KOMERCIAL

6.1 PERFORMANCAT - 2024

6.1.1 NUMRI I KONSUMATORËVE

Tabela nr. 6 – Numri i Konsumatorëve- 2023-2024

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA			
No.	Të dhënat	2023	2024
1	Shtëpiak	52,035	54,362
2	Ndryshimi		2,327
3	Ndryshi. %		4.5%
4	Kome.-Indu.	6,585	6,864
5	Ndryshimi		279
6	Ndryshi. %		4.2%
7	Institucional	343	355
8	Ndryshimi		12
9	Ndryshi. %		3.5%
10	TOTAL	58,963	61,581
11	Ndryshimi		2,618
12	Ndryshi. %		4.44%


Diagrami nr. 3 – Numri i Konsumatorëve- 2023-2024



Tabela nr. 7 – Numri i Konsumatorëve – Caqet 2024

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA			
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2024	JAN-DHJET - 2024(PB)
1	Shtëpiak	54,362	53,908
2	Ndryshimi		454
3	Ndryshi. %		0.8%
4	Kome.-Indu.	6,864	6,679
5	Ndryshimi		185
6	Ndryshi. %		2.8%
7	Institucional	355	364
8	Ndryshimi		(9)
9	Ndryshi. %		-2.5%
10	TOTAL	61,581	60,951
11	Ndryshimi		630
12	Ndryshi. %		1.03%

Diagrami nr. 4 – Numri i Konsumatorëve – Caqet 2024



6.1.2 FATURIMI – m3

Tabela nr. 8 – Faturimi m3- 2023 -2024

FATURIMI - m3			
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2023	JAN-DHJET - 2024
1	Shtëpiak	6,778,431	7,222,613
2	Ndryshimi		444,182
3	Ndry. %		6.6
4	Kome.-Indu.	771,192	836,377
5	Ndryshimi		65,185
6	Ndry. %		8.5
7	Institucional	521,516	485,020
8	Ndryshimi		(36,496)
9	Ndry. %		(7.0)
10	TOTAL	8,071,139	8,544,010
11	Ndryshimi		472,871
12	Ndry. %		5.9%

Diagrami nr. 5 – Faturimi m3- 2023 -2024





Tabela nr. 9 – Caqet 2024

FATURIMI - m3			
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2024	JAN-DHJET - 2024 (PB)
1	Shtëpiak	7,222,613	7,108,668
2	Ndryshimi		113,945
3	Ndry. %		1.6%
4	Kome.-Indu.	836,377	1,170,651
5	Ndryshimi		(334,274)
6	Ndry. %		-28.6%
7	Institucional	485,020	670,996
8	Ndryshimi		(185,976)
9	Ndry. %		-27.7%
10	TOTAL	8,544,010	8,950,315
11	Ndryshimi		(406,305)
12	Ndry. %		-4.5%

Diagrami nr. 6 – Caqet 2024



6.1.3 FATURIMI – €

Tabela nr. 10 – Faturimi €- 2023 -2024

FATURIMI - €			
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2023	JAN-DHJET - 2024
1	Faturimi-€	5,465,127.98	5,708,069.62
2	Total- Shte.	4,119,857.06	4,375,852.76
3	Ndryshimi		255,995.70
4	Ndry. %		6.2%
5	Total- kome.	871,448.56	893,066.82
6	Ndryshimi		21,618.26
7	Ndry. %		2.5%
8	Total-Inst.	473,822.36	439,150.04
9	Ndryshimi		(34,672.32)
10	Ndry. %		-7.3%
11	Te tjera	50,832.26	49,821.78
12	Total	5,515,960.24	5,757,891.40
13	Ndryshimi		241,931.16
14	Ndry. %		4.4%

Diagrami nr. 7 – Faturimi €- 2023 -2024





Tabela nr. 11 – Faturimi €- Caqet 2024

FATURIMI - €			
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2024	JAN-DHJET - 2024 (PB)
1	Faturimi-€	5,708,069.62	6,136,810.19
2	Total- Shte.	4,375,852.76	4,330,562.36
3	Ndryshimi		45,290.40
4	Ndry. %		1.0%
5	Total- kome.	893,066.82	1,200,595.39
6	Ndryshimi		(307,528.57)
7	Ndry. %		-25.6%
8	Total-Inst.	439,150.04	605,652.44
9	Ndryshimi		(166,502.40)
10	Ndry. %		-27.5%
11	Te tjera	49,821.78	22,940.00
12	Total	5,757,891.40	6,159,750.19
13	Ndryshimi		(401,858.79)
14	Ndry. %		-6.5%

Diagrami nr. 8 – Faturimi €- Caqet 2024



6.1.4 ARKËTIMI – €

Tabela nr. 12 – Arkëtimi €- 2023 -2024

No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2023	JAN-DHJET - 2024
1	Total- Shtëpiak	4,178,475.75	4,664,059.38
2	Ndryshimi		485,583.63
3	Ndry. %		11.6%
4	Total-Komercial-Industrial	851,200.99	994,350.11
5	Ndryshimi		143,149.12
6	Ndry. %		16.8%
7	Total Institucional	445,770.13	402,390.04
8	Ndryshimi		(43,380.09)
9	Ndry. %		-9.7%
10	Total - ujë	5,475,446.87	6,060,799.53
11	Ndryshimi		585,352.66
12	Ndry. %		10.7%
13	Te tjera	46,907.35	40,824.10
14	Ndryshimi		(6,083.25)
15	Ndry. %		-13.0%
16	TOTAL	5,522,354.22	6,101,623.63
17	Ndryshimi		579,269.41
18	Ndry. %		10.49%

Diagrami nr. 9 – Arkëtimi €- 2023 -2024





Tabela nr. 13 – Arkëtimi €- Caqet 2024

No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2024	JAN-DHJET - 2024 (PB)
1	Total- Shtëpiak	4,664,059.38	4,070,728.62
2	Ndryshimi		593,330.76
3	Ndry. %		14.6%
4	Total-Komercial-Industrial	994,350.11	1,169,732.60
5	Ndryshimi		(175,382.49)
6	Ndry. %		-15.0%
7	Total Institucional	402,390.04	605,652.44
8	Ndryshimi		(203,262.40)
9	Ndry. %		-33.6%
10	Total - ujë	6,060,799.53	5,846,113.66
11	Ndryshimi		214,685.87
12	Ndry. %		3.7%
13	Te tjera	40,824.10	52,350.00
14	Ndryshimi		(11,525.90)

15	Ndry. %		-22.0%
16	TOTAL	6,101,623.63	5,898,463.66
17	Ndryshimi		203,159.97
18	Ndry. %		3.44%

Diagrami nr. 10 – Arkëtimi €- Cqet 2024



6.2 KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI KOMERCIAL

6.2.1 AKTIVITETET KRYESORE

- Aktivitet kryesor nga departamenti komercial gjate vitit 2024 ishte rritje ne faturimi ku edhe si shihet nga raportet krahasim me vitin 2023 kemi një rritje 5.9% ose 472.871 m3 .
- Rritje ne faturim vërehet tek konsumatorët amvisëri me 444,182.00 m3 si dhe konsumatorët biznes me 65,185.00 m3 me shume se viti 2023,ndersa tek konsumatorët institucional kemi një rënie në faturim ku si arsyetim është që gjatë vitit 2023 objektet e kultit fetare nuk kane qenë të pajisur me ujëmatës por janë faturuar me një mesatare dhe gjate viti 2024 u është vendosur ujëmatës dhe janë faturuar sipas ujëmatësit.

- Kjo rritje në faturim është falë angazhimit të gjithë shërbimit me konsumatorë veçanërisht ekipet e inspektoratit ku gjatë gjithë vitit 2024 kanë inspektuar dhe identifikuar lidhje në shërbimin e ujit të pa-autorizuara si dhe identifikimin e konsumatorëve keqpërdorues, gjithashtu edhe angazhimi i lexuesve të ujëmatësive ku kanë identifikuar konsumatorët e ri të pa legalizuar, ujëmatësit jo funksional, rrjedhje të ndryshme etj.

6.2.2 ANKESAT TEKNIKE DHE KOMERCIALE

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas kohës dhe prioritetit të tyre.

Tabela nr. 13 – Ankesat teknike dhe komerciale -2024

1. Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	2917
1.1 Rrjedhje e ujit	numër	1722
1.2 Mungese e ujit	numër	1083
1.3 Rënie e presionit	numër	6
1.4 Cilësia e ujit	numër	28
1.6 Të tjera	numër	78
2. Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	892
2.1 Kontestim i borxhit, fatures	numër	619
2.2 Verifikim i leximit të ujëmatësit /te tjera	numër	223
2.3 Te tjera	numër	50

6.2.3 INSPEKTIMI DHE SHKYÇJA

Kanë vazhduar kontrollet në teren të konsumatorët nga ekipi i inspektimit dhe verifikimet tek konsumatorët dhe aktivitetet janë të prezantuara në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 14 – Inspektimi dhe shkyçja -2024

Njesite operative	Shperndarja e njoftimeve	Lidhjet e paligjshme	Shkyçjet për mos pagesë	Nr. i shkyçje. Totale	Verifikimi i leximit të ujëmatësve	Nr. i leximeve të gabuara	Rastet e dorezuara për gjykatë	Kontrata të riprogramimit
Prizren	18,847	1,014	3,287	4,301	8,111	61	265	135
Suharekë	4,489	30	344	374	5,507	5	80	46
Malishevë	3,673	37	57	94	915	14	44	11
Dragash	676	6	10	16	409	0	0	1
TOTAL	27,685	1,087	3,698	4,785	14,942	80	389	193

VII DEPARTAMENTI I FINANCEVE

7.1 KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI I FINANCEVE

7.1.1 AKTIVITETET KRYESORE

Ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një përformacë sa më të mirë të kompanisë.

- Punët ditore të zakonshme, si regjistrimi i arkave në bazë ditore, regjistrimet furnitorëve, depove si dhe aseteve për muajt përkatës.
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore për institucionet përkatëse si dhe vjetore;
- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajt përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrimit të të punësuarve.
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amvisërisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;

- Pranimi, kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, aprovimi i tyre për blerje dhe shpërndarja e materialit të blerë;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Barazimet e rregullta të arkave mobile me dorëzimin e mjeteve në bankë apo arken kryesore;
- Barazimet e rregullta të furnitorëve, pagesat e rregullta, sipas blerjeve;
- Regjistrimi i investimeve kapitale si dhe raportimi i tyre;
- Regjistrimet ditore në kontabilitet të hyrje/daljeve të materialit në depo;
- Plotesimin e librit të blerjes dhe shitjes sipas kërkesës nga ATK, për muajin përkatës;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj, sipas ligjeve në fuqi;
- Takimet e rregullta me menaxhmentin e kompanisë, lidhur me performancën dhe prezantimin e rekomandimeve për aktivitete të tjera për performancë më të mirë të kompanisë;
- Aktivitetet tjera për përmbylljen e vitit fiskal 2024;

7.1.2 ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE

Tabela nr. 15 – Shpenzimet 2023-2024

SHPENZIMET - €					
No.		JAN-DHJET - 2023	JAN-DHJET - 2024	DALLIMI	%
1	Total Shpenzimet Operative	4,689,047.15	4,989,756.84	300,709.69	6.41%
2	Pagat	2,879,712.25	3,054,944.84	175,232.59	6.09%
3	Rryma elektrike	1,016,147.70	1,041,751.95	25,604.25	2.52%
4	Shpen. e derivateve	117,716.28	121,752.98	4,036.70	3.43%
5	Mirem. dhe riparimet	185,992.06	272,763.78	86,771.72	46.65%
6	Mirem. e automjeteve	79,655.94	133,633.38	53,977.44	67.76%
7	Shpen.e taksave	109,390.16	109,703.00	312.84	0.29%
8	Kemikaliet	40,089.69	26,132.64	-13,957.05	-34.81%
9	Shpenzimet e tjera	260,343.07	229,074.27	-31,268.80	-12.01%

Diagrami nr. 11 – Shpenzimet 2023-2024






Tabela nr. 16 – Shpernzimet 2024- Caqet 2024

SHPENZIMET - €					
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2024	JAN-DHJET - 2024 (PB)	DALLIMI	%
1	Total Shpenzimet Operative	4,989,756.84	5,004,591.25	-14,834.41	-0.30%
2	Pagat	3,054,944.84	3,021,521.96	33,422.88	1.09%
3	Rryma elektrike	1,041,751.95	1,075,752.72	-34,000.77	-3.26%
4	Shpen. e derivateve	121,752.98	122,908.66	-1,155.68	-0.95%
5	Mirem. dhe riparimet	272,763.78	198,338.91	74,424.87	27.29%
6	Mirem. e automjeteve	133,633.38	68,230.48	65,402.90	48.94%
7	Shpen.e taksave	109,703.00	108,522.80	1,180.20	1.08%
8	Kemikaliet	26,132.64	46,327.08	-20,194.44	-77.28%
9	Shpenzimet e tjera	229,074.27	362,988.64	-133,914.37	-58.46%

Diagrami nr. 12 – Shpernzimet 2024- Caqet 2024



Shpenzimet operative vjetore 2024 të ndërmarrjes, në krahasim me shpenzimet e vjetore 2023, janë më të larta;

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo rënies së tyre;

Në pozicionin e pagave kemi një rritje prej 6% të shpenzimeve në krahasim me vitin e kaluar, për arsye se në mars të vitit 2023 është bërë nivelizimi dhe rritja e pagave gjë që ka kjo ka ndikuar në një rritje të shpenzimeve edhe në vitin 2024. Gjithashtu, në këtë kategori kemi rritje të bonuseve apo shtesave për grupet operative apo edhe grupet e inspektoratit/kontrolles, gjë që kanë ndikuar në rritje totale të shpenzimeve të pagave;

Edhe te pozicioni i energjisë elektrike kemi një rritje të lehtë, sidomos në njësinë e Prizrenit, ku dhe është koncentrimin më i madh i pompave dhe kjo ka ndikuar direkt edhe në rritje të shpenzimeve të energjisë elektrike;

Rritje të lehtë kemi edhe te shpenzimet tek pozicioni i derivateve në krahasim me vitin e kaluar, për 3 % janë më të larta, kjo vjen edhe si rezultat i blerjeve të reja të makinerisë, angazhimi i tyre si dhe çmimit të derivateve;

Rritje më të lartë të shpenzimeve kemi te kategoria e mirëmbajtjes në rrjet dhe në mirëmbajtjen e pompave. Në këtë vit, përveç intervenimeve në rrjet, kemi pasur edhe shumë intervenime elektrike pas defekteve të stacioneve të pompimit. Gjithashtu në këtë vit kemi pasur edhe një numër të madh të ndërrimit të ujëmatësve, gjë që të gjitha këto kanë ndikuar në rritje të shpenzimeve të këtij pozicioni;

Gjithashtu rritje më të madhe si përqindje kemi te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve, pra përveç mirëmbajtjes së defekteve dhe shpenzimeve të regjistrimit, në këtë vit kemi bërë edhe furnizim me goma të verës si dhe ato të dimrit afërsisht në vlerë prej 42 mijë euro, pothuajse për të gjitha automjetet e kompanisë. Pra kjo ka bërë që të rriten shpenzimet për këtë kategori;

Rritje të lehtë kemi pasur edhe te shpenzimet e taksave, pasi që edhe fatura mujore e ARRU-së është rritur nga 4,522.66 sa ishte në 2023 në 5,344.13 € në 2024. Por që këtë vit kemi pasur shumë më pak taksa përmbartimore së sa vitin 2023 për atë edhe si total i kësaj kategorie nuk është ndonjë ndryshim i madh;

Rënie të shpenzimeve kemi tek kategoria e kemikaleve dhe kategoria e shpenzimeve të tjera. Pra, në këtë kategori të shpenzimeve të tjera, përfshihen shpenzimet administrative, shpenzimet të jashtme profesionale, siç janë shpenzimet për mirëmbajtje të softuerit, mirëmbajtje për GPS, shpenzimet e provizioneve, ku në këtë viti kemi pasur më pak shpenzime të provizioneve, për shkak të ndërprerjes së kontratave me institucionet mikrofinanciare jo bankare;

Pra si përfundim, shpenzimet totale, për vitin 2024 kanë qenë më të larta në krahasim me vitin e kaluar, për arsyet e cekura më lartë.

VIII PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE

8.1 PERFORMANCAT 2023-2024 KRU „ HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Tabela nr. 17 – Performancat - 2023-2024- Caqet 2024

MUAI	JAN-DHJET- 2023	JAN-DHJET-2024	NDRYSHIMI	NDRY.%	2024 - PB	NDRYSHIMI	NDRY.%	REALIZIMI- %
Prodhimi m3	31,335,811	31,186,130	-149,681	-0.5%	29,990,340	1,195,790	3.99%	103.99%
Faturimi m3	8,071,139	8,544,215	473,076	5.9%	8,950,315	-406,100	-4.54%	95.46%
Faturimi nga ujl €	5,465,127.98 €	5,752,311.73 €	287,183.75 €	5.3%	6,136,810.19 €	-384,498.46 €	-6.27%	93.73%
Faturimi- te tjera €	50,832.06 €	45,531.89 €	-5,300.17 €	-10.4%	22,940.00 €	22,591.89 €	98.48%	198.48%
Faturimi Total €	5,515,960.04 €	5,797,843.62 €	281,883.58 €	5.1%	6,159,750.19 €	-361,906.57 €	-5.88%	94.12%
Inkasimi nga ujl €	5,475,446.87 €	6,060,799.53 €	585,352.66 €	10.7%	5,846,113.66 €	214,685.87 €	3.67%	103.67%
Inkasimi - te tjera €	46,907.35 €	40,824.10 €	-6,083.25 €	-13.0%	52,350.00 €	-11,525.90 €	-22.02%	77.98%
Inkasimi Total €	5,522,354.22 €	6,101,623.63 €	579,269.41 €	10.5%	5,898,463.66 €	203,159.97 €	3.44%	103.44%
Nr. I Konsumatorëve	58,963	61,581	2,618	4.4%	60,951	630	1.03%	101.03%
% e Inkasimit	100.2%	105.4%	5.2%	5.2%	95.3%	10.1%	10.60%	110.60%
Shpenzimet	4,689,047.15 €	4,989,756.84 €	300,709.69 €	6.4%	5,004,591.25 €	-14,834.41 €	-0.30%	100.30%
Pagat	2,879,712.25 €	3,054,944.84 €	175,232.59 €	6.1%	3,021,521.96 €	33,422.88 €	1.11%	98.91%
Rryma elektrike	1,016,147.70 €	1,041,751.95 €	25,604.25 €	2.5%	1,075,752.72 €	-34,000.77 €	-3.16%	103.26%
Shpe. e derivateveve	117,716.28 €	121,752.98 €	4,036.70 €	3.4%	122,908.66 €	-1,155.68 €	-0.94%	100.95%
